



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHËTËTOR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

**Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit:** Institucioni i Shëndetit Publik Shtëpia e Shëndetit „Dr. Haim Abravanel“ Manastir

**Lënda e revizionit:**

Revizioni i raporteve financiare bashkë me revizionin e pajtueshmërisë të llogarisë për të ardhurat personale - 531

**Qëllimi i revizionit:** Nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht dhe nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet në to janë në pajtim me rregullativën ligjore relevante.

**Gjendjet kyçe të konstatuara:**

- është paguar kompensim për jetë të ndarë të specialistëve në kohën kur u ndërpre praktika specialiste;
- ekzistojnë parregullsi në mënyrën e punës së thesarit dhe lëshimin e faturave fiskale për shërbimet shëndetësore të kryera;
- vaji për ngrohje në vlerë prej 1,618 mijë denarë nuk është evidentuar në evidencën materiale dhe të kontabilitetit;
- nuk është vendosur evidentimi i plotë i pajisjeve që jepen për përdorim gjatë lidhjes së marrëveshjes për qira;
- parregullsi gjatë zbatimit të prokurimit publik.

**Mendimi i dhënë/përfundim \*:**



Mendim me rezervë në lidhje me të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare dhe mendim i pavolitshtëm për pajtueshmërinë e transaksioneve financiare me rregullativën ligjore relevante për vitin 2020 transaksioneve financiare me rregullativën ligjore.

**Rekomandimet kyçe:**

- vendosjen e kontrolleve gjatë punës së thesarit dhe lëshimin e faturave fiskale për çdo shërbim shëndetësor të kryer;
- kompensim i plotë i shtesave pabazë të paguara për jetë të ndarë;
- evidentimi i materialit dhe kontabilitetit gjatë pranimit dhe konsumit të vajit për ngrohje;
- përgatitja e procesverbalit me të cilin do të përcaktohet saktë sipërfaqja e hapësirës së dhënë me qira dhe pajisjet e dhëna në shfrytëzim;
- sigurimin e konkurrencës, proporcionalitetit dhe përdorimit ekonomik të mjeteve gjatë zbatimit të procedurave për prokurime publike.

**Theksimi i çështjeve të pasigurisë dhe vazhdimësisë:**

Qendra shëndetësore ka kërkesa të papaguar nga Ministria për shërbimet e kryera shëndetësore nga programet e kujdesit shëndetësor në vlerë prej 8.309 mijë denarë.

**Vërejtjet e marra të draft-raportit:** janë pranuar vërejtje në një pikë të draft raportit që janë shqyrtuar, gjatë së cilës është vlerësuar se nuk janë pranuar sepse nuk janë pranuar dëshmi shtesë që do të ndikonin në ndryshimin e gjendjes së konstatuar.

\* pozitive, me rezervë të pavolitshtëm të përmbajtur